



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA HIMARË
KËSHILLI BASHKIAK

Nr. 63 prot.

Himarë, më 29.03.2024

**PROCESVERBAL I KËSHILLIT BASHKIAK HIMARË, ZBARDHUR NGA
ORGJINALI, MBI ZHVILLIMIN E MBLEDHJES PËR MUAJIN MARS.**

**Të ftuar: nënkryetarët e Bashkisë, drejtorit e Bashkisë, administratorët e njësive të
Bashkisë, kryetarët e fshatrave, Prefekti i Qarkut Vlorë, drejtues politik.**

1. Në mbledhje marrin pjesë këshilltarët:

Elisabeta Lamaj, Dhimitër Kapaj, Thodhori Foto, Mirka Gjiçali, Milto Nika, Aleks Llazari, Silva Burbo, Timoleo Gërdhuqi, Artan Bala, Thëllëza Kokaveshi, Artionil Shirokaj, Maks Vlasi, Miltiadh Prifti, Nikolinë Laska, Loreta Isufi, Nertila Husi, Fuat Mati, Qirjako Mërkuri, Afrovita Dhimojani, Gjergji Iliadhi.

Mungon :- Lenica Kocani.

Plotësohet kuorumi i këshilltarëve.

Mbledhjen e hap Kryetari Këshillit Z. Dhimitër Kapaj, ora 10:30

Përsëndetje të gjithëve, sikurse jeni në djeni jemi në një situatë jo normale ku kryetari i Bashkisë ka depozituar dorëheqjen pranë Këshillit, ndaj dua të propozoj në rendin e ditës të shtojmë pikë të parë këtë çështje. Jeni dakort? T'a miratojmë rendin e ditës?

Miratohet rendi ditës me (16) këshilltar pro

Në sallë tensionohet situata nga banorët ku mbështetës të kryetarit të votuar dhe dal fitues në zgjedhjet e katërmëdhjetë (14) maj, z. Fredi Beleri, prishën gjatësinë në sallë dhe nuk lejonin të zhvillohej mbledhja me brohorima dhe fjalë fyese ndaj drejtuesve politik në sallë dhe administratës.

Drejtuesi i Këshillit detyrohet të ndërpresë mbledhjen dhe t'i kërkojë kryesisë së Këshillit një mbledhje të menjëhershme.

Kryesia e përbërë nga dy nënkryetarët e këshillit, kryetari i këshillit, sekretar i Këshillit, kryetari i grupit të këshilltarëve të majtë, mungonte kryetarja e grupit të këshilltarëve koalicioni Bashkë Fitojmë. Kryesia vendosi që mbledhja të zhvillohet në ambientet e Bashkisë me dyer të mbyllura, në orën 12:00

Në orën 12:00, të gjithë këshilltarët e lart përmendur ju bashkuan sallës "Neço Muko" por këshilltarja Afrovita Dhimojani e cila e kundërshtoi këtë mbledhje, Silva Burbo, Thëllëza Kokaveshi, Miltiadh Prifti nuk ju bashkuan tavolinës e përbashkët me këshilltarët e tjerë.

Kryetari Këshillit hap mbledhjen dhe jep leje sekretares së Këshillit të lexoj nenin 6, të Rregullores së Këshillit dhe nenin 61,të ligjit për vetëqeverisjen vendore 139/2015

Kryetari Këshillit:- në rastin e situatës që ndodhemi ligji thotë ,nëse kryetari i Bashkisë në detyrë jep dorëheqjen të cilën e ka depozituar pranë Këshillit,e cila është protokolluar dhe bërë me djeni këshilltarëve në formë zyrtare nëpërmjet email,po kështu edhe Prefektit,ndaj sot duhet të caktojmë një nga dy nënkryetarët e Bashkisë për të drejtuar Bashkinë deri në zgjedhjen e kryetarit të ri,me votim të hapur.

Këshilltari Timoleo Gërdhuqi:- Me leje kryetar! Nëse njëri nga dy nënkryetarët dëshiron të tërhiqet le ta bëjë pa e hedhur në votim.

Nënkryetari Pervin Gjiguria deklaron se tërhiqet nga votimi.

Kryetarja e këshilltarëve të pozitës propozon Znj.Blerina Bala.

Kryetari i këshillit:- jeni dakort ?

Tërhiqet nga votimi këshilltari Artan Bala (pasi ka konflikt intersi,janë bashkëshort) pesëmbëdhjetë këshilltarë ngrenë dorën për pro ndaj Znj.Blerina Bala.

Miratohet vendimi nr.08 mbi caktimin e një prej zvëndëskryetarëve të Bashkisë Himarë për të kryer funksionet e kryetarit të bashkisë ,deri në zgjedhjen e kryetarit të ri,për shkak të dorëheqjes nga funksionet dhe detyra të Z.Jorgo Goro.

Nënkryetari Timoleo Gërdhuqi propozon se pikat e tjera të rendit të ditës t'i shtyjme për një datë tjetër sa më të afërt.

Këshilltarët janë dakort.

Nënkryetari këshillit ,Milto Nika:- mendoj që të kalojmë ndihmën ekonomike.

Këshilltarët e miratojnë me 16 ,vota pro.

Miratohet vendimi nr.09 ,mbi ndihmën ekonomike për periudhën 1 – 29 shkurt,nga fondi i kushtëzuar 6% I ndihmës ekonomike.

Kryetari këshillit përfundon mbledhjen duke uruar suksese Znj.Blerina Bala .

Procesverbali i mbledhjes u firmos nga gjashtëmbëdhjetë këshilltar (16) dhe Sekretari Këshillit.

Sekretari

Elena Memushaj